

Senad Hoxha

KUVENDI  
NR 377 DATE 29.01.25



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

Nr. \_\_ Prot.

Tiranë më, \_\_. \_\_. 2025

Lënda: Depozitim projektligji

Drejtuar: Znj. Elisa SPIROPALI  
KRYETARE E KUVENDIT TË SHQIPËRISË

E nderuar znj . Kryetare,

Mbështetur në nenin 81, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 68 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, ju paraqesim projekt-ligjin “Për një shtesë në ligjin nr. 10129, datë 11.5.2009 “Për gjëndjen civile” i ndryshuar.”

DEPUTETËT PROPOZUES

Sab Nensky  
 [Signature]  
 [Signature]  
 Shkurte [Signature]  
 EDI PALOKA [Signature]  
 Edmond Spata [Signature]  
 Orel Dyllyushi [Signature]  
 Gozment Berolli [Signature]  
 Stefan Noelburt [Signature]

Lheri Gjergji G  
 Ilda Shoni [Signature]  
 Klara Anila [Signature]  
 Lindita Metahory [Signature]  
 Elda Hoti [Signature]  
 Afron Gecmoraj [Signature]  
 [Signature]  
 Aslan Dajani [Signature]  
 Leftar Geshke [Signature]  
 duam . Bogi [Signature]

Saimun Koto ~~Shalle~~

Eranda Bano ~~Eranda~~

ANDIA ULLIR ~~Andia~~

Kastriot Isroli ~~Isroli~~ 2025

Stemur Nohu ~~Stemur~~

Xhela Mery ~~Xhela~~

QANI XHAGA ~~Qani~~

ANDREA MANO ~~Andrea~~

Saimir Fanelis ~~Saimir~~

Jnu Zhupa ~~Jnu~~

Ishqiptaria.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

PROJEKTLIGJ  
Nr. \_\_\_\_\_/2025

“PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 10129, DATË 11.5.2009 “PËR GJËNDJEN CIVILE” I NDRYSHUAR.”

Në mbështetje të neneve 78, 81 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me një propozim deputetësh,

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar.”, bëhet kjo shtesë:

**Neni 1**

Pas nenit 38/1 shtohet nen i ri 38/2 me këtë përmbajtje si vijon:

*“Gjini biologjikisht e pandryshueshme”*

Në Republikën e Shqipërisë në kuptimin e këtij ligji ka vetëm dy gjini njerzore, gjinia mashkull dhe gjinia femër dhe mbeten të pandryshueshme gjinia e përcaktuar ligjërisht që me aktin e lindjes, e cila mund të jetë mashkull ose femër. Në këtë kuptim gjini biologjikisht e pandryshueshme i referohet specifikisht për:

- a) “Grua” ose “gratë” dhe “vajza” ose “vajzat” do të nënkuptohen respektivisht të moshës madhore ose të mitur.
- b) “Burrë” ose “burrat” dhe “djalë” ose “djemtë” do të nënkuptohen respektivisht të moshës madhore ose të mitur.
- c) “Femër” nënkupton një person që i përket, që në lindje sipas karakteristikave shkencore fiziologjike dhe anatomike të njohura dhe pranuar botërisht, të seksit që prodhon qelizën e madhe riprodhuese.
- d) “Mashkull” nënkupton një person që i përket, që në lindje sipas karakteristikave shkencore fiziologjike dhe anatomike të njohura dhe pranuar botërisht, të seksit që prodhon qelizën e vogël riprodhuese.

## **Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR  
ELISA SPIROPALI**

[shqiptaria.com]

## **RELACION** **I PROJEKTLIGJIT**

“PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 10129, DATË 11.5.2009 “PËR GJËNDJEN CIVILE” I  
NDRYSHUAR.”

### **I. QËLLIMI I PROJEKT AKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Mbrojtja e shenjtërisë dhe paprekshmërisë së shoqërisë shqiptare dhe familjes tradicionale në veçanti mbetet një prerogativë e pandryshueshme, një detyrim jo vetëm kushtetues, por dhe moral e njerzor. Çdo qytetar që lind në Republikën e Shqipërisë i garantohen të drejta të barabarta të njohua me ligj në mënyrë të pacënueshme, të patjetërsueshme, të pandashme dhe të ndërlidhura. Në këtë kuptim shteti duhet të jetë në gjendje të mbrojë dhe garantojë njëherazi paprekshmërinë dhe pandryshueshmërinë e ekzistencës së individit, që nga lindja e duke shoqëuar përgjatë gjithë jetës së tij si qytetar e deri në vdekje.

Megjithatë, vihet re tendenca të njëpasnjëshme për të shtrëmbëruar e duke ndikuar në shenjtërinë e shoqërisë dhe familjes tonë të bazuar në vlerat humane, tradicionale dhe ato europiane. Këto tendenca kërkojnë të ndërhyjnë në mënyrë të padrejtë në gjenezën e jetës dhe formës njerëzore që e njih dhe e garanton vetë kushtetuta, e cila është akti themelor i Republikës së Shqipërisë. Kërkohej të na sillet si diçka normale, perëndimorizuese, apo dhe humane ndryshimi i gjinisë së të rriturve apo të fëmijëve në veçanti, në çfarëdo moshe apo gjendje fizike, dhe për pasojë lejjimin e ndryshimeve të mëpasshme për ti hapur rrugë ndërhyrje në institucionin e shenjtë të martesës jo vetëm midis gjinive të ndryshme, adoptimit, surrogacisë, etj.. Në gjykimin tonë këto akte apo tentativa deri të tanishme janë një provokim i hapur ndaj vlerave e normave të bashkejetesës sonë shoqërore, parimeve më të larta njerëzore, demokratike dhe europiane.

Ky projektligj ka për qëllim për të përcaktuar në mënyrë më ekspicite dhe të qartë përcaktimin ligjor mbi gjininë e individit që në lindje në mënyrë të patjetërsueshme dhe të pacënueshme nga asnjë autoritet apo individ i ngarkuar me fuqinë që mund t’ia japë ligji për të vepruar me apo pa vullnetin e individit të interesuar për të ndryshuar gjininë e tij/saj të ndryshme nga përcaktimi biologjik që në aktin e lindjes. Ndaj propozohet që në “ligjin nr. 10129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar.”, të bëhet një shtesë pas nenit 38/1, një nen i ri “38/2” që përcakton “gjininë biologjike të pandryshueshme”.

Poashtu kjo iniciativë që i drejtohet legjislatorit kombëtar merr shkas nga përpjekja e shumë vendeve dhe eksperiencave ndërkombëtare të cilat janë përballur ndër vite tashmë me këto tendenca kundër shenjtërisë së familjes dhe në tjetërsim të gjinisë së individëve ndryshe nga si janë lindur. Nën pretekstin e shoqërisë së hapur dhe të emancipuar tashmë janë të shumta rastet në vendet e Europës, SHBA apo më gjërë, ku në mnëyrë të pavullnetshme ose dhe të orientuar padrejtësisht, mijëra të mitur specifikisht por dhe të rritur, janë gjymtuar duke kaluar procedura të

ndryshimit të gjinisë së tyre nga ajo e mbartura që në lindje. Këto akte qartësisht shkojnë në kundërshtim me normat dhe vlerat e përbashkëta që mbrojnë familjen tradicionale, në lidhje me ndryshimin e gjinisë së të rriturve por dhe fëmijëve me apo pa maturinë për të vendosur një veprim të tillë, kërkojnë ta çlirojnë shoqërinë në vendet respektive nga kjo trysni si një normë sociale dhe pseudo-përparimtare. Më konkretisht së fundmi një akt me fuqi ligji ka qënë iniciativa e presidentit të sapo emëruar z. Donald Trump, i cili nëpërmjet urdhërit ekzekutiv të 20 Janar 2025, ndalon fenomenin që po dehumanizon shoqërinë e vendit të tij dhe po krijon trauma të pariparueshme sidomos për të miturit që përballen me këto procedura mjeksore dhe psikologjike të ndryshimit të gjinisë nga ajo që ata kanë lindur më herët.

Aktualisht në legjislacionin kombëtar, nuk ka një përkufizim të qartë të njohjes dhe garantimit të pandryshueshmërisë së gjinisë biologjike të individëve që prej lindjes, por nisur nga tentativa të njëpasnjëshme të grupeve apo individëve të cilët kërkojnë ti imponohen shoqërisë norma apo vlera të cilat janë të pabazuara shprehimisht në ligj, por dhe nuk kufizohen apo sanksionohen ndryshe, mund të krijojnë premisat të cilat sjellin më pas pasoja të rënda ndaj shenjtërisë së familjes tonë tradicionale, si dhe jetesën e çdo individi në shoqërinë tonë.

Në këtë kuptim projektligji parashikon të plotësojë ligjin nr. 10129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar.” duke përcaktuar:

- Se në Në Republikën e Shqipërisë, në kuptimin e këtij ligji ka vetëm dy gjini njerzore, gjinia mashkull dhe gjinia femër;
- Gjinia mbetet e pandryshueshme e cila është përcaktuar ligjërisht që me aktin e lindjes, që mund të jetë mashkull ose femër.
- Andaj në këtë kuptim gjini biologjikisht e pandryshueshme i referohet specifikisht për:
  - i) “Grua”/“gratë”; “vajza”/“vajzat” për gjininë femërore që në lindje, të seksit që prodhon qelizën e madhe riprodhuese; dhe
  - ii) “Burrë”/“burrat”; “djalë”/“djemtë” për gjininë mashkullore që në lindje, të seksit që prodhon qelizën e vogël riprodhuese.

## **II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME.**

Projektligji i propozuar, “për një shtesë në ligjin nr. 10129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile” i ndryshuar”, vjen si një plotësim i kuadrit ligjor të brendshëm për të parandaluar apo kufizuar interpretimet ose hendeqet e dispozitave në fuqi të cilat mund ti hapin rrugë ndryshimin të gjinisë për çdo individ ndryshe nga ajo që ai/ajo ka lindur. Vëmendja kryesore e këtij projekt-akti i drejtohet specifikisht të miturve, por jo vetëm, të cilët në pamundësi të përgjegjësisë juridike për të vepruar mund të bëhen padrejtësisht objekt i këtyre ndërhyrjeve nga individë në moshë madhore të autorizuar nga ligji për të marrë vendime në emër e të miturit, plotësisht pa e paragjykuar lidhjen midis tyre, duke i ndryshuar gjininë e tij/saj nga përcaktimi biologjik që në aktin e lindjes. Për më tepër ky plotësim kërkon të përcaktojë qartësisht se gjinia e pandryshueshme biologjike i referohet

konceptit që seksi i një individi i përcaktuar nga tipare shkencore fiziologjike dhe anatomike specifike të pranuar dhe njohura botërisht, është i fiksuar dhe nuk mund të ndryshohet nëpërmjet ndërhyrjeve mjekësore ose sociale. Poashtu kërkohet të vihet theksi për të parandaluar apo kufizuar çdo hapësirë ose hendek aktual ligjor i cili krijon mundësi për aplikueshmërinë e këtyre ndërhyrjeve. Kështu sanksionohet shprehimisht se në Republikën e Shqipërisë dhe në kuptimin e këtij ligji lejohen dhe mbeten të pandryshueshme gjinia e përcaktuar ligjërisht që me aktin e lindjes, e cila mund të jetë mashkull ose femër. Së fundmi shtesa e kësaj dispozite në “*ligjin nr. 10129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar*” specifikon dhe përkufizon në mënyrë të saktë termat përkatës për gjinitë biologjikisht të pandryshueshme të cilat janë:

- “Grua” ose “gratë” dhe “vajza” ose “vajzat” do të nënkuptohen respektivisht të moshës madhore ose të mitur.
- “Burrë” ose “burrat” dhe “djalë” ose “djemtë” do të nënkuptohen respektivisht të moshës madhore ose të mitur.
- “Femër” nënkupton një person që i përket, që në lindje sipas karakteristikave shkencore fiziologjike dhe anatomike të njohura botërisht, të seksit që prodhon qelizën e madhe riprodhuese.
- “Mashkull” nënkupton një person që i përket, që në lindje sipas karakteristikave shkencore fiziologjike dhe anatomike të njohura botërisht, të seksit që prodhon qelizën e vogël riprodhuese.

### **III. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.**

Projektligji propozohet bazuar në përcaktimet e nenit 81, pika 1, të Kushtetutës dhe është në përputhje me nenet 78, 83, pika 1 të Kushtetutës dhe miratimi i tij kërkon një shumicë të thjeshtë votash.

Projektligji nuk bie ndesh me ndonjë nen të Kushtetutës së Shqipërisë, dhe për më tepër është në harmoni me legjislacionin në fuqi.

Poashtu ky propozim ligjor, është formalisht në përputhje të plotë me kushtet e nenit 68 pika 2 e Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

### **IV. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS E BASHKIMIT EVROPIAN**

Ky projektligj nuk synon përafrimin me ndonjë akt të *acquis* të BE-së.

### **V. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektligji përbëhet nga 2 nene.

**Neni 1**, shtohet një nen i ri 38/2 në ligjin nr.10129 datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile” i cili përcakton “gjininë biologjikisht e pandryshueshme” i cili sanksionon se në Republikën e Shqipërisë në kuptimin e këtij ligji ka vetëm dy gjini njerzore, gjinia mashkull dhe gjinia femër.

Në vijim theksohet se gjinia mbetet e pandryshueshme, e cila është përcaktuar ligjërisht që me aktin e lindjes, dhe që mund të jetë mashkull ose femër. Prandaj në këtë kuptim gjini biologjikut e pandryshueshme i referohet specifikisht për: i) "Grua"/"gratë"; "vajza"/"vajzat" për gjininë femërore që në lindje, të seksit që prodhon qelizën e madhe riprodhuese; dhe ii) "Burrë"/"burrat"; "djalë"/"djemtë" për gjininë mashkullore që në lindje, të seksit që prodhon qelizën e vogël riprodhuese.

**Neni 2** parashikon hyrjen në fuqi të projektligjit në përputhje me nenin 84 të Kushtetutës.

## VI. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji nuk parashikon as kosto në buxhetin e shtetit të vitit korrent e asnjë efekt financiar në vijimësi.

Në përfundim, duke çmuar gjykimin e secilit prej deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, pavarësisht pozicionit politik, vlerësojmë se ky projektligj është një mjet shtesë për të linjësuar qartësisht përcaktimin ligjor mbi gjininë e individit që në lindje në mënyrë të patjetërsueshme dhe të pacënueshme nga asnjë autoritet apo individ i ngarkuar me fuqinë që mund t'ia japë ligji për të vepruar me apo pa vullnetin e individit të interesuar për të ndryshuar gjininë e tij/saj të nga përcaktimi biologjik që në aktin e lindjes. Në këtë kuptim projektligji përcakton se në Republikën e Shqipërisë dhe në kuptimin e këtij ligji lejohen dhe mbeten të pandryshueshme gjinia e përcaktuar ligjërisht që me aktin e lindjes, e cila mund të jetë mashkull ose femër.

### DEPUTETËT PROPOZUES

*Luigj Berisha*  
*Meri*

*Trita Shehu*

*Shkurte Çupi*

EDI PALOKA

*Edmond Spata*

*Oerd Bylyk*

*Gazment Bardhi*

*Beqir Nallbati*

*Llëni Gjergji*

*Ilda Shani*

*Flamur Aoshu*

*Liridita Medonj*

*Elda Hoti*

*Afrim Hajmerka*


*Armando Sula*


*Aslan Doga*

*Lefer Gërbet*


*Ilir Baci*





Solius Koto 

~~Orakel Bano~~ 


ANDIA ULLURI 

Kashriot Israli  2029

Flamur Neba 

Michael Muz 

QANI XHAFIA 

ANDREA MAMO 

Saimir Kaveshi 

Jona Zhupa 

Ishqiptaria.com